



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III

Komisioni për të Drejtat e Njeriut,
Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione
Mbledhja nr. 44
Prishtinë, më 07.10. 2009, në orën 13:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

PROCESVERBAL

Nga dëgjimi publik i Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore,
Persona të Pagjetur dhe Peticione

Në dëgjim morën pjesë: Ismet Beqiri – kryetar, Hajredin Hyseni, Radmila Vujoviq, Nerxhivane Dauti, Sanije Alijaj, Luljeta Shehu, Ibrahim Makolli, Naim Rustemi, Danush Ademi dhe Shpresa Murati.

Të ftuar: Zyra e Qeverisë për Personat e Zhdukur, Prenk Gjetaj - ICMP –KNPZH, Luigj Ndou – OHCHR, Xhemajl Ahmeti, Haki Kosumi - KAFZHK, Musa Gashi - Mjekësia Ligjore, Valeri Brasej – EULEX, Elita Vokshi – OSCE, Barrie Simpson – ICMP, Musa Gashi – ZPZHML, Naim Uka – ZPZHML, Qëndresa Mulaj e Arben Emini– ZPZHML dhe Flora Brovina, deputete në Kuvendin e Republikës së Kosovës.

Dëgjimin e mbikëqyrën: Elita Vokshi – OSBE, Afërdita Sylja – NDI, Rrezarta Ahmeti – KDI, Nexhat Shatri – Zyra e Presidentit, Afërdita Uka – Zëri, Barrie Simpson – ICMP, Musa Gashi, Naim Uka, Qëndresa Mulaj dhe Arben Emini – ZPZHML.

Nga Staf i Mbështetës i Komisionit: Rrahim Demaj – koordinatori, zyrtar i lartë dhe Visar Krasniqi - zyrtar ligjor.

***Kryetari** konstatoi se ishin plotësuar kushtet, në bazë të Rregullores së punës të Kuvendit të Republikës së Kosovës, për mbajtjen e dëgjimit publik dhe propozoi këtë*

R e n d d i t e

1. Identifikimi i mbetjeve mortore dhe zbardhja e fatit të personave të pagjetur

Kryetari, i përshëndeti të pranishmit dhe sqaroi se qëllimi i dëgjimit është ta sensibilizojë dhe të ndihmojë punën në zbardhjen e fatit të të pagjeturve, numri i të cilëve nuk është i vogël. Edhe pas 9 vjetësh në Kosovë janë të pagjetur edhe 1.938 persona, përfshirë këtu edhe mbetjet mortore që gjenden në murgun e Mjekësisë Ligjore në Prishtinë.

Megjithëse Kuvendi i Kosovës e miratoi Deklaratën para 4 vjetësh, në të cilën nga të gjithë

faktorët relevantë u kërkua ta ushtrojnë ndikimin e tyre për zbardhjen e fatit të të gjithë të rrëmbyerve dhe të të pagjeturve, si dhe kthimin e shpejtë e të pakushtëzuar të tyre, ose të trupave të tyre të identifikuar, ose të paidentifikuar. Familjarët janë të zhgënjyer me veprimet e deritashme dhe kërkojnë të sensibilizohen institucionet vendore dhe ato ndërkombëtare, për t'i dhënë fund pritjes së tmerrshme, plot ankth e dëshpërim të pafund. Komisioni do t'i marrë opinionet tuaja dhe në një nga mbledhjet e radhës do te pregadisë rekomandimet .

Kushtrim Gara - nga Zyra e Komisionit Qeveritar për Personat e Zhdukur, në vija të trasha i njoftoi të pranishmit për punën që është bërë deri tani dhe për mekanizmat që do të merren për identifikimin e mbetjeve mortore, por pa i anashkaluar edhe të tjerët. Ai tha se procesi i identifikimit ka pasur zvarritje, që ka shkaktuar pakënaqësi te familjarët, por kërkohet bashkërendimi i punëve dhe të fillojë procesi i identifikimit.

Tarja Farmisto, përfaqësuese e EULEX-it, ka dhënë detaje për të gjitha shifrat, përkitazi me mbetjet mortore, që janë të paidentifikuara në murg, qoftë sa u përket pjesëve të eshtrave, që i kanë në dispozicion, përkatësisë gjinore dhe prejardhjes së tyre etj. Ajo tha se hap i ardhshëm do të jetë kontrollimi i çdo faze të procesit të deritashëm. Gjithashtu e ngriti çështjen e eshtrave të djegur pa identifikim sipas metodës së ADN-së.

Luigj Ndou, nga Komisioni Ndërkombëtar për Personat e Zhdukur (ICMP), paraqiti shifra për mostrat e marra nga eshtrat e familjeve të të zhdukurve, të atyre të identifikuara dhe të atyre që nuk kanë përputhje profilet që i kanë në dispozicion. Ai sqaroi se Komisioni ofroi ndihmë teknike në procesin e zbardhjes së fatit të të pagjeturve. Këtë ndihmë ICMP-ja e ka realizuar si bartëse e identifikimit të mbetjeve mortore sipas metodës së ADN-së, metodë më e sigurt shkencore për identifikim.

Mbetja e mëse 400 mbetjeve mortore të paidentifikuara në morgun e Institutit të Mjekësisë Ligjore është rezultat i trajtimit të këtyre mbetjeve.

Haki Kasumi, udhëheqës i Këshillit Koordinues të Asociacioneve të Familjeve të të pagjeturve, theksoi se raportimet i vlerësoi të përsëritura dhe me shifra që janë bërë të mërzitshme. Sa i përket funksionimit të shumë komisioneve për çështjen e të pagjeturve, tha se më tepër janë formale, sa për ta arsyetuar ekzistimin dhe formimin e tyre. Shoqëria nuk ka bërë përpjekje serioze për ta kuptuar këtë dhimbje.

Sanije Alijaj - Theksoi se përfaqësuesit e institucioneve kompetente nuk paraqiten në mënyrë të qartë, se cilat janë sfidat për koordinimin e punëve me mekanizmat ndërkombëtarë dhe vendorë, për ta përshpejtuar zbardhjen e fatit të personave të pagjetur. Ajo i shtroi pyetje përfaqësuesit të ICMP-së dhe të Institutit të Mjekësisë Ligjore, se me rastin e dorëzimit të mbetjeve mortore familjarëve të tyre, a u jepet raporti kryesor, se u është dorëzuar trupi duke mos specifikuar mungesën e pjesëve të caktuara?

Qëndresa Mulaj, parafolëses iu përgjigj se në raportin e dorëzuar familjarëve nuk përshkruhen pjesët e dorëzuara të mbetjeve mortore, specifikimet mbeten në dosjet tona dhe se familjarët kanë të drejtë të kenë qasje.

Ibrahim Makolli - Kërkoj të thuhet qartë se kush është fajtor për ngecjen e procesit të zbardhjes së fatit të të zhdukurve. Ai tha se nuk ka dëgjuar asgjë të re në këto raportime dhe kërkoj të ketë përgjigje të saktë pse nuk janë identifikuar rreth 400 mbetje mortore dhe për çfarë arsye ato nuk përputhen me mostrat e marra nga familjarët. Mund të flasim gjithçka, por qytetarit nuk i intereson. Atij i intereson rezultati.

Drita Maliqi, u pajtua se nuk është bërë asgjë për zbardhjen e fatit të personave të pagjetur. Ajo shtroi pyetje, a ka mundësi Qeveria ta pajisë me laborator dhe me aparaturë të identifikimit të mbetjeve mortore? Ishte e mendimit se dërgimi për specializim i kuadrit vendor duhet të shihet si mundësi e mirë e zgjidhjes së çështjes.

Luljeta Shehu - E ka njoftuar Komisionin për përmbajtjen e deklaratës së Sahit Hotit, ish-banor i Gjakovës, dhe pyeti: pse është gjithë ky mosinteresim përkundër detajeve që përmban deklarata? Çka do të bëhet me ato kufoma nëse familjet e tyre nuk pajtohen me atë identifikim?

Flora Brovina, deputete e Kuvendit të Kosovës - Ceku se ka munguar bashkëpunimi ndërmjet institucioneve kompetente për zbardhjen e fatit të personave të pagjetur. Ajo tha se nuk është bërë presion te faktori ndërkombëtar dhe tek ai serb. Rikujtoi se procesi i identifikimit të mbetjeve mortore në murgun e Rahovecit pothuajse nuk ka lëvizur fare. Pastaj shtroi edhe një numër pyetjesh të tjera: sa dhe si po zbatohet Rezoluta për personat e pagjetur? A keni lokacione të shënuara që presin për t'u hulumtuar? Cila është strategjia për të bërë presion në Serbi?

Hajredin Hyseni - Pyeti sa po harmonizohen qëndrimet me institucionet kompetente për hulumtimin dhe gjetjen e personave të pagjetur dhe cili është roli i Komisionit Qeveritar për personat e pagjetur ? Pyetjeve të secilit pjesëmarrës iu dha përgjigje në fushën përkatëse.

Ismet Beqiri - Ceku se Kuvendi i Kosovës e miratoi Deklaratën para 4 vjetësh, në të cilën nga të gjithë faktorët relevantë u kërkuar ta ushtronin ndikimin e tyre për zbardhjen e pashtyeshme të fatit të të gjithë të rrëmbyerve dhe të të pagjeturve, si dhe kthimin sa më parë e të pakushtëzuar të tyre ose të trupave të tyre të identifikuar ose të pidentifikuar. Familjarët janë të zhgënjyer me veprimet e deritashme dhe kërkojnë të sensibilizohen institucionet vendore dhe ato ndërkombëtare për t'i dhënë fund pritjes së tmerrshme, plot ankth e dëshpërim të pafund.

Prandaj ishte konstatim i të gjithë pjesëmarrësve, që familjeve të të zhdukurve t'u mundësohet e drejta për të ditur për të zhdukurit e tyre. Duke u mbështetur në Deklaratën Ndërkombëtare të Kombeve të Bashkuara për persona të pagjetur, të miratuar në shkurt 2003 në Gjenevë, familjarët kanë të drejtë të dinë për fatin e më të dashurve të tyre të rrëmbyer, kanë të drejtë të dinë ku gjenden, a janë gjallë dhe - nëse kanë vdekur, si është shkaktuar vdekja e tyre, kush e ka bërë krimin dhe ku janë varrezat?

Në këtë dëgjim është ngritur çështja e Projektligjit për të pagjeturit dhe është kërkuar të dihet në cilën fazë gjendet. Sërish u kërkuar nga Qeveria e Kosovës përsheptimi i procedimit të Projektligjit për persona të pagjetur. Komisioni ka kapacitet për draftimin e tij.

Komisioni vendosi që nga dëgjimi i mbajtur të nxirren përfundimet dhe në bazë të tyre të kërkohet lejimi i debatit në seancën plenare, në mënyrë që t'u ndihmohet familjeve, sepse e meritojnë.

Dëgjimi publik
përfundoi në orën 15 : 20

Kryetari i Komisionit

Ismet Beqiri

